L I G J
Nr.8806, datë 17.5.2001

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8563, DATË 22.12.1999 "PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË BANKËS SË KURSIMEVE SH.A."

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K UV E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 1 të ligjit nr.8563, datë 22.12.1999 "Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a. bëhen këto shtesa:

Në rreshtin e dytë, pas fjalëve "nëpërmjet shitjes" shtohen fjalët "ose shitjes me kusht".

Po në këtë nen, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në rast se marrëveshja për transferimin e të drejtës së pronësisë të aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a. do të bëhet me kushte, kjo marrëveshje duhet të miratohet nga Kuvendi."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3047, datë 5.6.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani